

Përgatitur nga:



RAST STUDIMOR

**Ndikimet buxhetore të
procesit të integritimit në BE
në Ballkanin Perëndimor**

***Rasti i Republikës
së Kosovës***



Ky rast studimor është përgatitur nga ekipi i **Impact Assessment Institute**:

Erik Akse

Joana Naçi

Jona Jaha

Senem Safçi

Dizajn nga:

Spontan Creative Media

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Ky rast studimor është produkt i ekipit të **Impact Assessment Institute**. Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë rast studimi bazohen në diskutimet me palët e interesit dhe punën kërkimore të kryer nga ekipi ynë. Ju jeni të lirë të kopjoni, shpërndani, transmetoni dhe përshtatni këtë punë, përfshirë edhe për qëllime komerciale, duke cituar: **'Ky rast studimor është përgatitur nga Impact Assessment Institute'**.

Ndikimet buxhetore të procesit të integritimit në BE në Ballkanin Perëndimor

Rasti i Republikës së Kosovës

Infografika

Produktet që krijojnë të ardhura më të larta për shkak të importit të karburanteve (436 milionë euro), cigareve (281 milionë euro) dhe veturave (91 milionë euro).

Objektivat e politikës së BE-së:

Marrëveshja e Gjelbër Evropiane: Lëndët djegëse fosile klimatike, kalimi në automjete me emetim zero.

Plani i BE-së për të mposhtur kancerin: Përpjekja për një shoqëri pa duhan.

Humbja e parashikuar e të ardhurave deri në vitin 2040:



Karburanti:

218 milionë euro
50% deri në 2040



Cigaret

231 milionë euro
82% deri në 2040



Vetura

45 milionë euro
50% deri në 2040

Gjithësej:

490 milionë euro
20% e të ardhurave buxhetore deri në vitin 2040

Rekomandime:

1. Zhvillimi i një strategjie afatgjatë të të ardhurave.
2. Zhvillimi i Planit të Investimeve për Integrimin Evropian: vlerësim gjithëpërfshirës i kërkesave dhe kostove të zbatimit që rezultojnë nga Integrimi Evropian.
3. Përfshirja e objektivave të BE-së në planifikimin financiar:

- integrimi i objektivave të politikave të BE-së në parashikimet e të ardhurave dhe kostove ndërkohë që po zhvillohen politika të reja të BE-së.
4. Krijimi i praktikës së vlerësimit të ndikimeve të politikave të BE-së ndërkohë që janë ende në zhvillim e sipër.
5. Forcimi i politikave që synojnë nxitjen e rritjes ekonomike.

Përmbledhje e gjetjeve kryesore



Kosova është në rrugën e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Rrugëtimi i Kosovës drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian përfshin një përkushtim për t'u përafuar me politikat dhe standardet e BE-së. Ky studim tregon ndikimin në të ardhurat doganore të lidhura me importin e tre produkteve me të ardhura më të larta, përkatësisht lëndët djegëse fosile, cigaret dhe veturat, nëse përmbushen disa objektiva të politikës së BE-së nga Marrëveshja e Gjelbër e BE-së dhe Plani i BE-së për të mposhtur kancerin. Studimi parashikon që vetëm për këto tre kategori produktesh, Kosova do të kishte një humbje vjetore të të ardhurave prej **(490 milionë euro), e barazvlezhme me një reduktim prej 20% nga buxheti i vitit 2022¹**. Kostot e parashikuara nuk

përfshijnë humbjen shtesë të të ardhurave nga TVSH-ja nga këto produkte, duke lënë të kuptohet se ndikimi aktual mund të jetë më i lartë.

Ky ndikim i jashtëzakonshëm në të ardhurat e qeverisë do të thotë se duhet të ndërmerren veprime tani. Qeveria e Kosovës duhet të zhvillojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të ndikimeve të të ardhurave dhe kostove që rezultojnë nga procesi i integritit në BE. Ky vlerësim është vendimtar për financimin e reformave të rëndësishme të nevojshme në ekonomi, administratë dhe në shoqëri për t'u përafuar me standardet evropiane. Qeveria gjithashtu duhet të zhvillojë kapacitetet për të përcaktuar ndikimet e politikave të BE-së ndërkohë që ato janë ende në zhvillim e sipër.

TABELA E PËRMBAJTJES

1	Hyrje	06
2	Metodologjia	08
3	Gjetjet e Studimit	10
3.1	Marrëveshja e Gjellbër e BE-së për Energjinë	11
3.2	Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022 - 2031	11
3.3	Marrëveshja e Gjellbër e BE-së për Lëvizshmërinë	13
3.4	Strategjia e Transportit Multimodal 2023-2030	14
4	Plani i BE-së për Mposhtjen E Kancerit	16
4.1	Prevalenca e konsumit të duhanit dhe sfidat rregullatore Kosovë	18
5	Përfundime	20
6	Referenca	22

1
Hyrje

←←←
20%
reduktim i të
ardhurave të
qeverisë deri në
2040

Ky studim synon të vlerësojë ndikimet buxhetore afatmesme dhe afatgjata të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian (BE) në vendet e Ballkanit Perëndimor (BP). Studimi fokusohet në një grup specifik të objektivave të politikës së BE-së për produktet që importohen dhe sigurojnë pjesën më të madhe të të ardhurave nga doganat dhe akcizat. Në mënyrë të veçantë, ky studim fokusohet në implikimet e objektivave të politikës së BE-së në tre produktet me të ardhura më të larta, përkatësisht karburantet, veturat dhe cigaret, në rastin e Kosovës.

BE-ja ka vendosur objektiva specifike të politikave për këto produkte, ndërsa në Kosovë, këto objektiva janë inkorporuar në mënyrë indirekte në dokumente të ndryshme strategjike të nivelit kombëtar. Për të përfunduar me sukses procesin e Integritimit Evropian, do të thotë që këto objektiva duhet të përfshihen plotësisht në hartimin e politikave kombëtare. Rezultatet e këtij studimi tregojnë implikimet e jashtëzakonshme buxhetore që synimet e politikave të BE-së mund të kenë në të ardhurat e qeverisë. Objektivat e politikës së BE-së vetëm për importet e karburanteve dhe cigareve, do të çonin në reduktim **20% të të ardhurave të qeverisë deri në vitin 2040** . Kërkohet veprim tani për të siguruar që kjo humbje e të ardhurave të kompensohet.

Nevoja për veprim rritet edhe më tej kur merren parasysh investimet e nevojshme për të përbushur objektivat e BE-së dhe për të zbatuar standardet e BE-së në të gjitha aspektet e shoqërisë dhe ekonomisë. Marrëveshja e Gjelbër e BE-së, dixhitalizimi, reforma e sektorit bujqësor, Reforma e Administratës Publike dhe zhvillimi i politikave gjithëpërfshirëse që mbrojnë grupet vulnerabel janë vetëm disa shembuj të politikave që do të kërkojnë angazhim dhe investim të konsiderueshëm nga qeveria.



Metodologjia

Ky studim bazohet në një metodë kërkimore cilësore e cila përfshin një hulumtim të plotë dhe intervista gjysmë të strukturuar/diskutime të hapura me palët kryesore të interesit të qeverisë dhe shoqërisë civile që punojnë në fushat e politikave përkatëse të këtij studimi.

Hulumtimi përfshinte një analizë të objektivave të politikës për tre produktet me të ardhura më të larta, që janë karburanti, veturat dhe cigaret. Objektivat e politikave të BE-së u vlerësuan përmes analizës së Marrëveshjes së Gjellbër të BE-së dhe Planit të BE-së për të mposhtur kancerin, pasi këto politika ndikojnë ndjeshëm jo vetëm në vendet anëtare të BE-së, por edhe në kombet që aspirojnë për anëtarësim në BE në mënyrë indirekte. Këto objektiva të politikave të BE-së janë krahasuar me objektivat e politikave kombëtare të përcaktuara nga qeveria e Kosovës në dokumente të ndryshme strategjike të nivelit kombëtar.

Analiza u pasua nga diskutime të hapura me palët e interesit të qeverisë dhe shoqërisë civile. Në këto diskutime u përfshinë zyrtarë të lartë nga Departamenti i Energjisë në Ministrinë e Ekonomisë, Drejtori i Departamentit të Automjeteve në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Kosovë, si dhe Drejtori Ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë. Diskutimet kanë përfshirë edhe zyrtarët e lartë nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, hulumtuesit nga Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim (OJF-organizatë jofitimprurëse) në mesin e fushave të tjera që punon për prevalencën e pirjes së duhanit në Kosovë), Ushtruesin e detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm si dhe Këshilltarin e Ministrit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për të diskutuar objektivat e importit për produkte ushqimore, pasi ushqimi fillimisht u vlerësua si kategoria e katërt me të ardhurat më të larta nga importi në Kosovë. Megjithatë, në bazë të diskutimeve me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit

Rural u bë e qartë se importi nuk pritet të ndryshojë ndjeshëm si rezultat i zbatimit të objektivit të politikës së BE-së.



3
Gjetjet e Studimit



3.1 - Marrëveshja e Gjelbër e BE-së për Energjinë

Marrëveshja e Gjelbër e BE-së vendos objektiva të ndryshme politikash në fusha të tilla si klima, energjia, transporti dhe taksat me synimin për të reduktuar emetimet neto të gazrave serrë me 55% deri në vitin 2030². Për më tepër, ajo synon të reduktojë emetimet neto të gazrave serrë deri në vitin 2050 në zero.

Si pjesë e reduktimit të emetimeve neto të gazrave serrë, vendet e BE-së nën këtë Marrëveshje ranë dakord gjithashtu të krijojnë legjislacion më të fortë për të rritur kapacitetet për energjinë e ripërtëritshme. Ky objektivi është vendosur si një minimum prej 42.5% deri në vitin 2030, duke përfaqësuar një rritje prej 32% nga situata aktuale, me një ambicie për të arritur në 45%.³ Për më tepër, objektivi i efikasitetit të energjisë për BE-në është vendosur në 11.7% deri në vitin 2030. Për të përmbushur këtë objektivi, vendet anëtare të BE-së duhet të bëjnë kursime vjetore prej një mesatareje prej 1.49% nga 2024 deri në 2030.⁴

3.2 - Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022 - 2031

Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës është dokumenti themelor dhe më i rëndësishëm në nivel kombëtar i cili përcakton drejtimit dhe veprimet kryesore dhe ofron udhëzime për veprimet kryesore për zhvillimin e sektorit të energjisë gjatë 10 viteve të ardhshme në Kosovë. Një nga objektivat kryesore strategjike të kësaj strategjie është dekarbonizimi nëpërmjet promovimit të energjisë së ripërtëritshme. Qëllimi i këtij objektivi është futja e dekarbonizimit në sektorin e energjisë në Kosovë, përmes çmimit gradual të karbonit dhe transpozimit të rregulloreve kryesore të BE-së. Procesi i vendimit lidhur me politikat e çmimeve të karbonit ende nuk kanë marrë formë përfundimtare në Komunitetin e Energjisë. Në varësi të vendimeve në Komunitetin e Energjisë do të percaktohen edhe skemat e çmimeve të karbonit në të ardhmen. Duke synuar veçanërisht sektorin e energjisë, plani promovon përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe

heqjen graduale të prodhimit të energjisë me bazë linjiti. Teknologjitë e reja kanë për qëllim të ulin emetimet e GHG-së me synim arrijen e synimeve të Deklaratës së Samitit të Sofjes deri në 2050. Ndërsa kjo strategji fokusohet vetëm në qëllimet e sektorit të energjisë, Strategjia e Transportit Multimodal 2023-2030 dhe Strategjia Kombëtare për Sektorët Industrialë (e cila është ende në zhvillim), do të synojë të mbulojë fusha të tjera të dekarbonizimit. Këto dy strategji, së bashku me Strategjinë e Energjisë, do të integrohen në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2025-2030.

Bazuar në standardet e Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës, qëndrueshmëria dhe neutraliteti i klimës do të arrihet

përmes reduktimit të emetimeve të gazrave serrë për të paktën 32% në vitin 2031⁵ në sektorin e energjisë në Kosovë dhe përmes dekarbonizimit dhe promovimit të energjisë së ripërtëritshme për të ulur emetimet e gazrave serrë në sektorin e energjisë duke mbuluar fillimisht të paktën 35% të konsumit të energjisë elektrike nga energjia e ripërtëritshme deri në vitin 2031.⁶ Për më tepër, kjo strategji synon të arrijë kursime kumulative të energjisë prej 266.4 ktoe (kilotonë) në ndërtesa, duke përfshirë ato publike, private dhe komerciale deri në vitin 2031.⁷

Tranzicioni drejt burimeve të energjisë së ripërtëritshme do të kërkojë investime të rëndësishme paraprake në infrastrukturën e re të energjisë. Këto investime nuk janë marrë parasysh në këtë studim.

Fusha e Politikave	Objektivi i politikës së BE-së	Objektivi i Politikës së Kosovës
Reduktimi neto i emetimeve të gazrave serrë	55% deri në vitin 2030 0 deri në vitin 2050	32% deri në vitin 2031 <i>(vetëm objektivi i sektorit të energjisë elektrike)</i> 12% deri në vitin 2026 <i>(vetëm objektivi i sektorit të transportit)</i> 20% deri në vitin 2030 <i>(vetëm objektivi i sektorit të transportit)</i>
Energjia e Ripërtëritshme	42.5% deri në vitin 2030	minimalisht 35% deri në vitin 2031
Objektivi i efikasitetit të energjisë	11.7% deri në vitin 2030	N/A
Kursimet vjetore të energjisë	1.49% nga 2024 deri në 2030	Kursime kumulative të energjisë prej 266.4 ktoe (kilotonë) vetëm në ndërtesa duke përfshirë ato publike, private dhe komerciale deri në vitin 2031



3.3 - Marrëveshja e Gjelbër e BE-së për Lëvizshmërinë

Marrëveshja e Gjelbër e BE-së gjithashtu ofron objektiva specifike të politikave për lëvizshmërinë, duke synuar arritjen e lëvizshmërisë më të gjelbër përmes zgjidhjeve të transportit të pastër, të arritshëm dhe të përbalueshëm. Bazuar në këtë fushë të politikës, të gjitha veturat dhe furgonat e reja të regjistruara në BE do të kenë emetim zero deri në vitin 2035.⁸ Një objektiv afatmesëm për të arritur emetimet zero vendos që emetimet mesatare të veturave të reja të jenë më pak në 55% deri në vitin 2030 dhe furgonëve të rinj në 50% deri në vitin 2030.⁹ Kjo do ta vendosë transportin rrugor në një rrugë të qëndrueshme drejt lëvizshmërisë me emetim zero në vitin 2050.

Përveç reduktimit të emetimeve të CO₂, objektivat e politikave për lëvizshmërinë ofrojnë gjithashtu fusha përmirësimi për të nxitur përdorimin e transportit të pastër nga qytetarët e BE-së. Një nga këto fusha është krijimi i infrastrukturës së dedikuar për karikimin e automjeteve me emetim zero. Këto objektiva mandatojnë zbatimin e infrastrukturës së karikimit elektrik dhe karburantit me hidrogjen në të gjitha territoret e BE-së. Kapaciteti i karikimit duhet të plotësojë kërkesat e një flote më të madhe veturash me emetim zero. Për më tepër, objektivi i politikës së BE-së e bën gjithashtu të detyrueshëm futjen e çmimit të karbonit deri në vitin 2027, ku transportet rrugore do të mbulohen nga tregtia e emetimeve, duke vendosur një çmim mbi ndotjen, duke stimuluar përdorimin e karburantit më të pastër dhe duke ri-investuar në teknologji të pastra.¹⁰



3.4 - Strategjia e Transportit Multimodal 2023-2030

Strategjia e Transportit Multimodal 2023-2030 synon të arrijë një sistem transporti të qëndrueshëm dhe të integruar duke forcuar mënyra të ndryshme, zgjidhje më efikase të transportit dhe duke e bërë të gjithë sektorin më miqësor ndaj mjedisit, më të sigurt dhe me kosto efektive. Kjo strategji plotëson Strategjinë e Energjisë 2022-2031 duke përfshirë sektorin e transportit në objektivin e qeverisë për të arritur Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor.¹¹ Bazuar në reduktimin e emetimit të CO₂ nga sektori i transportit, kjo strategji vendos objektivat e reduktimit me

5% deri në vitin 2026 dhe 10% reduktim deri në vitin 2030 për veturat, 20% reduktim deri në vitin 2026 dhe 25% reduktim deri në vitin 2030 për kamionët transportues dhe autobusët.¹²

Përderisa nuk ka objektiva të qarta për çmimin e karbonit për sektorin e transportit, Strategjia e Energjisë së Kosovës përcakton objektiva të qarta ku të gjitha përgatitjet për zbatimin e sistemit të çmimit të karbonit deri në vitin 2025 do të përfundojnë. Arritja e këtij objekti do të lehtësonte zbatimin e një mekanizmi të çmimit të karbonit që do të rritet në mënyrë graduale derisa Kosova të integrohet në tregun pan-Evropian dhe në Sistemin e Tregtimit të Emetimeve të BE-së (ETS). Bazuar në këtë,

objektivi është çmimi gradual deri në vitin 2030 (15% në 2025, sesa marrja lineare).¹³

Bazuar në vlerësimin e Strategjisë së Energjisë së Kosovës, pjesa e veturave elektrike në vitin 2021 ishte 0.05%, pasi në atë vit janë importuar vetëm 157 vetura elektrike dhe hibride, krahasuar me 333,000 vetura me naftë ose benzinë të importuara në të njëjtin vit.¹⁴ Trendi i importit të veturave elektrike dhe hibride pritet të rritet, veçanërisht për kompanitë e taksive të cilët po kalojnë drejt përdorimit të këtyre llojeve të veturave.

Në përputhje me objektivat e Strategjisë së Transportit, e cila parashikon promovimin e transportit të qëndrueshëm dhe promovimin e veturave më të pastra, veçanërisht veturave me karburant alternativ, Strategjia e Energjisë merr parasysh elektrifikimin gradual të sektorit të transportit kur parashikon konsumin e energjisë elektrike.

Masat për arritjen e këtij qëllimi përcaktohen në strategjinë e transportit duke krijuar bazën ligjore nëpërmjet miratimit të Direktivës 2014/94/BE dhe duke përcaktuar kornizën e politikave kombëtare për zhvillimin e një rrjeti të infrastrukturës alternative të karburantit (p.sh. stacionet e karikimit me energji elektrike për vetura) dhe promovimi i blerjes së veturave me emetim zero.

Kalimi nga veturat me karburante fosile në vetura me emetim zero pritet të vendosë një kërkesë në buxhetin e Kosovës pasi që veturat me emetim zero përgjithësisht subvencionohen. Kjo do të thotë se të ardhurat nga importi i veturave do të reduktohen, të paktën për një periudhë kohore . Për më tepër, kalimi në lëndë djegëse të reja për veturat me emetim zero do të kërkojë investime të rëndësishme paraprake në infrastrukturën e re të energjisë. Këto investime nuk janë marrë parasysh në këtë studim.

Fusha e Politikave	Objektivi i politikës së BE-së	Objektivi i Politikës së Kosovës
Reduktimi i emetimeve të CO ²	Reduktim 55% e emetimeve nga veturat deri në vitin 2030 Reduktim 50% të emetimeve nga furgonat deri në vitin 2023 0 emetime nga veturat e reja deri në vitin 2035	5% deri në 2026 për veturat 10% deri në 2030 për veturat 20% deri në 2026 për kamionët transportues dhe autobusët 25% deri në 2030 për kamionët transportues dhe autobusët
Infrastruktura e karikimit elektrik dhe karburantit me hidrogjen	Për tu prezantuar	N/A
Çmimi i karbonit	Prezantimi i detyrueshëm deri në vitin 2027	Çmimi gradual deri në vitin 2030 (15% në 2025, sesa marrja lineare)



Plani i BE-së për mposhtjen e kancerit

Plani i BE-së për mposhtjen e kancerit vendos objektiva specifike të politikave për të reduktuar përdorimin, shitjen dhe reklamimin e duhanit. Bazuar në këtë plan, BE-ja synon të ketë një Shoqëri Pa Duhan, ku më pak se 5% e popullsisë përdor duhan deri në vitin 2040, krahasuar me rreth 25% në gjendjen aktuale.¹⁵ Qëllimi i përkohshëm i BE-së është të arrijë objektivin e reduktimit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë prej 30% deri në vitin 2025, që korrespondon me një reduktim të prevalencës së konsumit të duhanit prej rreth 20%.

Ky plan i referohet në mënyrë specifike Direktivës për Produktet e Duhanit dhe Direktivës për Tatimin e Duhanit. Këto dy direktiva përdoren si instrumente efektive për të luftuar konsumin e duhanit në BE. Direktiva për Produktet e Duhanit, e miratuar fillimisht në vitin 2014, aktualisht është vendosur për një përditësim për t'u përafëruar me tregun e brendshëm të BE-së.¹⁶ Përveç kësaj, Direktiva për Tatimin e Duhanit përcakton një taksë për të reduktuar konsumin e duhanit. Në nivel të BE-së, objektivi kërkon që shtetet anëtare të vendosin një normë minimale të akcizës për cigaret.¹⁷





4.1 - Prevalenca e konsumit të duhanit dhe sfidat rregullatore në Kosovë

Nuk ka strategji kombëtare që fokusohen në mënyrë specifike në reduktimin e prevalencës së konsumit të duhanit në Republikën e Kosovës. Strategjia për Promovimin e Shëndetit në Shkolla dhe Ligji Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit vendosin bazën për rregullimin e reklamave dhe importeve të cigareve, ndalimin e konsumimit të duhanit në hapësira të mbyllura dhe promovimin e stileve më të shëndetshme të jetesës tek brezat e rinj. Një studim krahasues i kryer nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë, tregon konsumin mes grave dhe burrave duke zbuluar në mënyrë kumulative një prevalencë të konsumit të duhanit prej 27.7% në vitin 2019.¹⁸ Vihet re se ka ende probleme të theksuara në zbatimin e ligjit, veçanërisht në sektorin e gastronomisë. Përveç kësaj, një fokus i veçantë do t'i kushtohet importit dhe konsumit të cigareve elektronike dhe vapave (vejp). Në të ardhmen, Dogana e Kosovës do të prezantojë kode specifike për cigaret elektronike dhe vapa (vejp) për tatim dhe akcizë. Prevalenca e konsumit të duhanit në Kosovë është relativisht e lartë në krahasim me disa nga vendet e tjera të Evropës.

Fusha e Politikave	Objektivi i politikës së BE-së	Objektivi i Politikës së Kosovës
Reduktimi i përdorimit të duhanit	më pak se 5% deri në vitin 2040	N/A
Gjithsej barra tatimore	7.5% deri në 76.5% deri në vitin 2040	<p>Akciza me normë specifike prej 47 € për 1,000 cigare</p> <p>Tatimi mbi Vlerën e Shtuar prej 18%</p> <p>Taksa doganore 10%, përveç Serbisë dhe Malit të Zi 0% dhe Shqipërisë dhe Maqedonisë 1%.</p> <p>Nuk ka asnjë objektiv të TTB-së (gjithsejt barrës tatimore) për Kosovën</p>

Të ardhurat doganore: Pasqyra e ndikimit

	Fusha e Politikave	Objektivi i politikës së BE-së	Objektivi i politikës së Kosovës	Të hyrat rrethëse doganore (Kosovë)	Të hyrat e pritshme doganore (Kosovë)
Marrëveshja e Gjelbër e BE-së për Energjinë	Reduktimi i emetimeve të gazrave serrë	55% deri në vitin 2030 0 deri në vitin 2050	32% deri në vitin 2031 (vetëm objektivi i sektorit të energjisë elektrike) 12% deri në vitin 2026 (vetëm objektivi i sektorit të transportit) 20% deri në vitin 2030 (vetëm objektivi i sektorit të transportit)	Të ardhura nga importi i karburantëve 2022 436 milionë €	Reduktim 50% deri në vitin 2040: -218 milionë € Reduktim 100% deri në vitin 2050: - 436 milionë €
	Energjia e Ripërtërishme	42.5% deri në vitin 2030	minimalisht 35% deri në 2031	N/A	N/A
	Objektivi i eficiencës së energjisë	11.7% deri në vitin 2030	N/A	N/A	N/A
Marrëveshja e Gjelbër e BE-së për Lëvizshmërinë	Kursimet vjetore të energjisë	1.49% nga 2024 deri në vitin 2030	Kursime kumulative të energjisë prej 266.4 kton në ndërtesa duke përfshirë ato publike, private dhe komerciale deri në vitin 2031	N/A	N/A
	Reduktimi i emetimit të CO ₂	Reduktim 55% i emetimeve nga veturat deri në vitin 2030 Reduktim 50% i emetimeve nga furgonat deri në vitin 2023 0 emetime nga veturat e reja deri në vitin 2035	5% deri në vitin 2026 për veturat 10% deri në vitin 2030 për veturat 20% deri në vitin 2026 për kamionët transportues dhe autobusët 25% deri në vitin 2030 për kamionët transportues dhe autobusët	Të ardhurat nga të gjitha veturat në vitin 2022: 91 milionë € ²⁰	Reduktim 50% deri në vitin 2040: - 45 milionë €
	Infrastruktura e karikimit elektrik dhe karburantit me hidrogjen	Për tu prezantuar	N/A		
Plani i BE-së për të mposhtur kancerin	Çmimi i karbonit	Prezantimi i detyrueshëm deri në vitin 2027	Çmimi gradual deri në vitin 2030 (15% në 2025, sesa marja lineare)		
	Reduktimi i përdorimit të duhanit	më pak se 5% deri në vitin 2040	Norma aktuale e prevalencës : është 27.7% ⁶	Të ardhurat nga importi i cigareve 2022 281,65 milionë € ²¹	Reduktim 82% deri në vitin 2040: - 231 milionë €
<p>Humblja totale e parashikuar e të ardhurave sipas skenarit të mos ndryshimit të politikës deri në vitin 2040 490 milionë €</p>					



Përfundime

Ka implikime të rëndësishme buxhetore afatmesme të politikave dhe objektivave të politikave të BE-së në të ardhurat e doganave në Republikën e Kosovës, veçanërisht humbje të të ardhurave nga importi i karburantit dizel/naftë, importet e veturave dhe importet e cigareve. Pa ndonjë ndryshim të politikave, humbja totale e të hyrave nga doganat pritet të jetë 490 milionë euro. Kjo shumë është e barabartë me gjithsej 20% të të ardhurave të qeverisë së Kosovës bazuar në buxhetin e vitit 2022.

Gjetjet e këtij studimi tregojnë se ka një thirrje urgjente për veprim të menjëhershëm. Qeveria duhet të zhvillojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të ndikimit afatmesëm dhe afatgjatë të procesit të integritimit në BE në të ardhurat në mënyrë që të jetë në gjëndje të adresojë sfidën e mungesës së parashikuar në të ardhurat doganore. Kjo duhet të përfshijë një kuptim të qartë të efekteve të politikave të reja të BE-së gjatë zhvillimit të tyre. Duke kuptuar në mënyrë gjithëpërfshirëse ndikimin e pritshëm, Qeveria mund të hartojë dhe zbatojë masa për të neutralizuar çdo mungesë të mundshme në të ardhurat doganore dhe të ardhurat nga burime të tjera.

Përveç kësaj, Qeveria duhet të zhvillojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të investimeve të nevojshme për zbatimin me sukses të Acquis të BE-së, veçanërisht duke u fokusuar në politikat me kostot më të larta të lidhura. Kjo përmbledhje gjithëpërfshirëse shërben si një mjet për të siguruar që të ardhurat dhe kërkesa për investime në të ardhmen të

jenë në një linjë. Duke vlerësuar këto aspekte, qeveria mund të garantojë që burimet financiare të akorduara të përputhen me kërkesat e paraqitura nga procesi i integritimit në BE.

Për të mbajtur një fokus të qartë në ndikimet e Integritimit Evropian, qeveria duhet të ndërtojë kapacitete të fuqishme të dedikuara për përcaktimin e ndikimeve të politikave të BE-së ndërkohë që këto janë ende në zhvillim e sipër. Kjo qasje nënkupton angazhimin dhe bashkëpunimin aktiv me institucionet e BE-së, duke i vënë një theks të veçantë nxitjes së partneriteteve me Komisionin Evropian. Kjo qasje proaktive do t'i mundësojë qeverisë së Kosovës që të harmonizojë strategjitë e saj në mënyrë më efektive, duke siguruar një proces më të qetë integruar dhe duke lehtësuar vendimmarrjen e informuar. Kjo mund të kombinohet më së miri me një vlerësim gjithëpërfshirës të kërkesave të zbatimit dhe kostove përkatëse që rezultojnë nga kërkesat për të transpozuar Acquis të BE-së dhe për të arritur standardet e BE-së në praktikë.

E fundit, dhe sigurisht jo më pak e rëndësishme, me rritjen e nevojës për investime për financimin e procesit të Integritimit Evropian, qeveria duhet të forcojë të gjitha politikat e saj që synojnë nxitjen e rritjes ekonomike. Kjo rritje do të jetë një faktor i rëndësishëm për të kompensuar humbjet në të ardhura dhe për të mbuluar nevojat për investime të integritimit në BE.

A large, light blue number '6' is positioned in the bottom-left corner of the page. It is semi-transparent, allowing the white text 'Referenca' to be visible through it.

Referenca

Faqe 4

¹Shih LIGJIN NR. 08/L-193 PËR NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2023 për shifrat e të ardhurave të vitit 2022 të shfrytëzuara për qëllimin e këtij studimi.

Faqe 11

²Marrëveshja e Gjelbër e BE-së - marrë nga:
https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/european-green-deal_en

^{3,4}Marrëveshja e Gjelbër e BE-së, Energjia e Ripërtërishme - marrë nga:
https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/european-green-deal/delivering-european-green-deal_en

Faqe 12

^{5,6,7}Strategjia e Energjisë së Kosovës - marrë nga:
<https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/04/Energy-Strategy-of-the-Republic-of-Kosovo-2022-2031-1-1.pdf>

Faqe 13

^{8,9,10} Marrëveshja e Gjelbër e BE-së, Lëvizshmëria e Gjelbër - marrë nga:
https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/european-green-deal/delivering-european-green-deal_en

Faqe 14

¹¹Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor - marrë nga:
https://www.rcc.int/priority_areas/61/green-agenda-for-the-western-balkans

¹²Strategjia e Transportit Multimodal 2023-2030 - marrë nga:
<https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/05/MULTIMODAL-TRANSPORT-STRATEGY-2030.pdf>

Faqe 15

^{13,14}Strategjia e Energjisë së Kosovës - marrë nga:
<https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/04/Energy-Strategy-of-the-Republic-of-Kosovo-2022-2031-1-1.pdf>

Faqe 16

¹⁵Plani i BE-së për të mposhtur kancerin - marrë nga:
https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:8dec84ce-66df-11eb-aeb5-01aa75ed71a1.0002.02/DOC_1&format=PDF

¹⁶Direktiva për Produktet e Duhanit (2014/40/BE) - marrë nga:
https://health.ec.europa.eu/tobacco/product-regulation/implementing-tobacco-products-directive-directive-201440eu/revision-tobacco-products-directive_en

¹⁷Direktiva për Tatimin e Duhanit (2011/64/BE) - marrë nga:
<https://www.europarl.europa.eu/legislative-train/theme-an-economy-that-works-for-people/file-tobacco-directive-revision>

Faqe 17

¹⁸Hulumtimi i nivelit ekspozimit ndaj tymit të dhe qendrimet e qytetareve për politikën e kontrollit të duhanit në Kosovë, 2020, KADC dhe KFOS.

Faqe 19

^{19,20,21}Raporti Vjetor 2022, Dogana e Kosovës
https://dogana.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/08/Raporti_vjetor_2022.pdf

